



Duke Mbështetur Qeverisjen e Mire dhe Qytetarinë Aktive
Supporting Good Governance and Active Citizenry

Monitoruesi i Gjykatave

Raport i monitorimit të seancave gjyqësore në
Gjakovë dhe Podujevë

DHJETOR 2013

**Publikimi i këtij Raporti u mundësua me mbështetjen e popullit
amerikan përmes USAID/ATRC. Qëndrimet në këtë Raport nuk reflektojnë
qëndrimet e USAID.**



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



Monitoruesi i Gjykatave

Hyrje

Sistemi i drejtësisë është shtyllë kyçe dhe e rëndësishme substanciale për ndërtimin e një shteti me demokraci funksionale dhe zbatimin e ligjit. Fatkeqësisht sistemi i drejtësisë në Kosovë përballet me sfida nga më të ndryshmet që nga mungesa e besimit të qytetarëve për arsye nga më të ndryshmet e deri te problemet që mund të cilësohen si mungesë e kapaciteteve njerëzore, probleme teknike apo logjistike por që të gjitha ndikojnë në cilësinë e punës së sistemit të drejtësisë në tërësi.

Ligji nr. 03/L-199 i cili është miratuar në vitin 2012 për Gjykatat në Kosovë ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013. Ky ligj ka sjellë transformim dhe reforma substanciale në sistemit gjyqësor, mirëpo rezultatet në përmirësimin e cilësisë së punës, nivelit të transparencës dhe llogaridhënies mbetet ende të shihen.

Lëvizja FOL me qëllim që të kontribuoj në përmirësimin e gjendjes në sistemin e drejtësisë në maj 2013 me mbështetjen nga populli amerikan përmes USAID/ATRC ka filluar implementimin e projektit “Afrimi i qytetarëve me institucionet e drejtësisë”.

Qëllimi kryesor i aktiviteteve të këtij projekti është monitorimi i zbatimit të të drejtës për një “Gjykim të Drejtë”, e drejtë kjo e garantuar me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut të vitit 1953 dhe Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike të vitit 1966 dhe rrjedhimisht e garantuar me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi të Kosovës, në seancat gjyqësore për rastet e ndërlidhura me korrupsionin dhe shpërdorimin e autoritetit publik. Përveç kësaj Lëvizja FOL ka synuar që përmes aktiviteteve avokuese në kuadër të projektit të krijojë kanale të

Monitoruesi i Gjykatave

reja të komunikimit mes qytetarëve dhe institucioneve të sistemit të Drejtësisë me qëllim rritjen e transparencës dhe llogaridhënies të këtij të fundit dhe rritjen e besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë.

Fushata avokuese e cila u realizua në kuadër të projektit përmbante në vete programe televizive dhe në radio me mysafir nga institucionet e sistemit të drejtësisë dhe diskutime për problemet dhe sfidat në sistemin e drejtësisë, organizimi i tryezave të rrumbullakëta me përfaqësues nga institucionet, shoqëria civile dhe mediat, përhapje e informacionit përmes rrjetit social Facebook, takime në vazhdimësi në mes të përfaqësuesve të institucioneve të drejtësisë dhe Lëvizjes FOL si dhe formimin e “Forumit për Qasje në Drejtësi”.

“Forumi për Qasje në Drejtësi” në Gjakovë dhe Podujevë u iniciua dhe u formua nga Lëvizja FOL me qëllim që të shërbejë si një kanal lehtësues i komunikimit mes qytetarëve dhe institucioneve të drejtësisë. Po ashtu “Forumi për Qasje në Drejtësi” ka për qëllim të shërbejë si platformë dhe pikëtakim ku akterët e ndryshëm duke përfshirë përfaqësues nga Gjykata, Prokuroria, Policia, shoqëria civile dhe mediat dhe para së gjithash qytetarët të diskutojnë për problemet që hasin çdo ditë në sistemin e drejtësisë dhe të prodhojnë ide për zgjidhjen e tyre. Po ashtu përfaqësuesit e Lëvizjes FOL në takimet e Forumeve të cilat u tentua të mbaheshin në periudha të rregullta kohore në të dy komunat përcollen problemet e evidentuara gjatë monitorimit të punës së Gjykatës.

Monitoruesi i Gjykatave

Monitorimi i Seancave Gjyqësore

Monitorimi i seancave gjyqësore të rasteve të ndërlidhura me korrupsionin dhe keqpërdorimin e pozitës apo autoritetit zyrtar ishte sfidë në vetvete. Lëvizja FOL në bashkëpunim me një ekspert të të drejtave të njeriut ka përgatitur metodologjinë dhe pyetësin në bazë të kësaj metodologjie për monitorimin e seancave në fjalë në kontekst të të drejtës për “Gjykim të Drejtë”.

Pavarësisht se sipas të dhënave zyrtare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për periudhën Janar-Shtator 2013 sa i përket veprave penale të korrupsionit dhe keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar në Gjykatën Themelore në Gjakovë janë të deponuara 3 lëndë të trashëguara nga vitet e kaluara dhe 1 lëndë e pranuar në punë gjatë kësaj periudhe, asnjë lëndë nuk është zgjidhur si dhe asnjë seancë gjyqësore për rastet e ndërlidhura me korrupsionin dhe keqpërdorimin e pozitës apo autoritetit zyrtar nuk është mbajtur nga asnjë gjykatës. Ky është një indikator tejet negativ për ecurinë apo rëndësinë që i është dhënë në vazhdimësi këtyre lëndëve nga ana e Gjykatës Themelore në Gjakovë. Arsyetimi i zyrtarëve të gjykatës për mos mbajtjen e këtyre seancave në vazhdimësi ka qenë se ata po merren me rastet të rënda të vrasjeve dhe se numri i madh i lëndëve që ata kanë nuk ju lejon kohë që të merren me caktimin e seancave për këto raste.

Përveç lëndëve të lartëcekura sipas të dhënave të Prokurorisë Themelore në Gjakovë ka 6 raste të mos-deklarimit të pasurisë të cilat janë në procedurë në Prokurori, kurse nga ana tjetër Policia e Kosovës në Gjakovë raporton se i ka dërguar në Prokurori 3 raste të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar gjatë zgjedhjeve lokale.

Monitoruesi i Gjykatave

Sa i përket komunës së Podujevës, me Ligjin e ri mbi funksionimin e Gjykatave në Kosovë, në Podujevë funksionon Dega e Gjykatës Themelore në Prishtinë. Gjithashtu në bazë të Ligjit të ri Podujeva nuk ka Prokuror rezidencial mirëpo funksionin në kuadër të Prokurorisë Themelore në Prishtinë. Lëndët e ndërlidhura me korrupsionin dhe keqpërdorimin e pozitës apo autoritetit zyrtar nga 1 Janari 2013 janë bartur nga Gjykata Themelore e Prishtinës- Dega në Podujevë tek Njësiti për Krime të Rënda në Gjykatën Themelore të Prishtinës. Pavarësisht kësaj me metodologjinë e përshkruar më lartë Lëvizja FOL ka tentuar që të monitorojë zhvillimin e këtyre rasteve të bartura në Prishtinë.

Sipas të dhënave zyrtare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës pavarësisht se për periudhën Janar-Shtator 2013 sa i përket veprave penale të korrupsionit dhe keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar në Gjykatën Themelore Prishtinë- Dega në Podujevë janë të deponuara 4 lëndë të trashëguara nga vitet e kaluara, asnjë lëndë nuk është zgjidhur si dhe asnjë seancë gjyqësore për rastet e ndërlidhura me korrupsionin dhe keqpërdorimin e pozitës apo autoritetit zyrtar nuk është mbajtur nga asnjë gjykatës. Sikur se edhe në rastin e Gjakovës ky është një indikator tejet negativ për ecurinë e punës dhe rëndësinë që ju jepet këtyre lëndëve, kurse arsyetimet janë pothuajse të njëjta.

Policia e Kosovës në Podujevë raporton se ka në punë 6 raste të ndërlidhura me korrupsionin dhe keqpërdorimin e pozitës apo autoritetit zyrtar, 5 nga të cilat janë të ndërlidhura me veprën penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar gjatë zgjedhjeve lokale kurse 1 është rast i marrjes së rryshvetit. Kurse ashtu siç edhe u cek më lartë Podujeva nuk ka Prokurori Themelore rezidenciale por rastet shkojnë përmes Prokurorisë Themelore në Prishtinë.

Konkluzionet dhe rekomandimet

Lëvizja FOL gjatë tentimeve për të monitoruar seanca gjyqësore ka evidentuar disa probleme në funksionimin e Gjykatës në dy komunitat relevante në këtë raport ndër të cilat: arritja tek informacioni qoftë ai edhe më i thjeshti është tejet i vështirë në gjykatë për shkak se ka procedura tejet burokratike, vonesat në shqyrtimin e lëndëve është një problem tjetër që ashtu siç u shtjellua në paragrafët mësipër jo rrallë ndikon edhe në cilësinë e punës së gjykatës, mungesë e kapaciteteve njerëzore si dhe teknike në Gjykatë etj. Të gjitha këto janë indikatorë negativ për nivelin e transparencës dhe llogaridhënies në Gjykatë por po ashtu edhe për zbatimin e standartit “Gjykim i Drejtë” gjatë shqyrtimit të këtyre lëndëve.

Lëvizja FOL rekomandon që: rasteve të ndërlidhura me korrupsionin dhe shpërdorimin e autoritetit publik tu jepet vëmendja dhe rëndësia e duhur pasi që kjo është ndër problematikat më madhore të shtetit tonë, qasja në informacion në Gjykata të bëhet më e lehtë për palët e interesuara dhe rrjedhimisht institucionet e drejtësisë të jenë më transparente dhe llogaridhënëse, të ndihmonen gjykatat si në aspektin e kapaciteteve njerëzore e po ashtu teknike sidomos në kontekstin e trajnimit të zyrtarëve për standardin “Gjykim i Drejtë” dhe të drejtat e njeriut në përgjithësi.



Falënderime

Publikimi i këtij Raporti u mundësua me mbështetjen e popullit amerikan përmes USAID/ATRC. Ky Raport është produkt i stafit të Lëvizjes FOL dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm. Në këtë kontekst, Lëvizja FOL falënderon publikisht të gjithë personat që punuan në sigurimin e informacioneve dhe përpilimin e këtij raporti. Të gjitha Raportet e Lëvizjes FOL janë të publikuara në këtë ueb faqe: www.levizjafol.org.

Rreth Lëvizjes FOL

Organizata është themeluar të mbështes qytetarinë aktive, të rris transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve publike për të kontribuar në qeverisje të mirë dhe parandalim të korrupsionit. Për t'i përmbushur qëllimin e saj, organizata do të ndër marrë aktivitetet si: debate dhe trajnime, konferenca, seminare dhe tryeza, publikime dhe hulumtime, avokim si dhe mbështetje teknike dhe institucionale, monitorimin e institucioneve publike si dhe mobilizim dhe rrjetëzim. Shpenzimi i fondeve publike, konflikti i interesit, neglizhenca dhe përgjegjësia institucionale si dhe qasja në informacione zyrtare, përbëjnë çështjet kryesore të punës së FOL.